



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/51  
Datë: 12.06.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**Për ndryshimin dhe plotësimin e Programit Legjislativ të vitit 2018 të Qeverisë së Republikës së Kosovës**

1. Në Programin Legjislativ të vitit 2018 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të përfshihen këto Projektligje:
  - 1.1. Projektligji për Traktatin e Komunitetit të Transportit (MI) – 24.08.2018;
  - 1.2. Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit të Projektit të Ekonomisë Digjitale të Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim (MF) -28.09.2018;
  - 1.3. Projektligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat (MF) – 28.09.2018;
  - 1.4. Projektligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (MF)- 28.09.2018;
  - 1.5. Projektligji për Tatimin në të Ardhura Personale (MF) – 28.09.2018;
  - 1.6. Projektligji për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave (MF) – 28.09.2018;
  - 1.7. Projektligji për Inspektime (MTI) – 30.09.2018;
  - 1.8. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Filharmoninë, Operën dhe Baletin (MKRS) 19.12.2018;
  - 1.9. Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet MASHT dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut lidhur me Projektin për zhvillim të bashkëpunimit KSV/): Mbështetje për reformën e arsimit dhe aftësimin profesional në Kosovë – faza 2 (MASHT) – 30.10.2018;

1.10. Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Bashkëfinancimit të Bursave në nivel të Studimeve Master ndërmjet MASHT dhe Ambasadës së Francës në Prishtinë (MASHT) – 10.12.2018.

2. Nga Programi Legjislativ i vitit 2018 të Qeverisë së Republikës së Kosovës tërhiqet:

1.2. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (MD);

3. Në Programin Legjislativ të vitit 2018 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të ndryshohet afati i miratimit nga Qeveria së Republikës së Kosovës për këto Projektligje:

3.1. Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes të Huas për rrugën Kijevë – Zahaq, në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim; (MF) – 28.09.2018;

3.2. Projekt Kodi Penal i Republikës së Kosovës (MD) -30.09.2018;

3.3. Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 04L/40 për Provimin e Jurisprudencës (MD) -30.10.2018;

3.4. Projektligji për Pronën Publike (MD) -30.09.2018;

3.5. Projektligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit (MD) -30.09.2018;

3.6. Projektligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik (MD) -30.09.2018

3.7. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-157 për Avokaturën Shtetërore (MD) -30.09.2018;

3.8. Projektligji për Banimin Social (MMPH) – 22.11.2018;

3.9. Projektligji për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në fushën e ndërtimit (MMPH) – 21.09.2018;

3.10. Projektligji për krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës (MMPH) – 29.09.2018;

3.11. Projektligji për kadastër të pronës së paluajtshme (MMPH) – 26.11.2018;

3.12. Projektligji për mbeturinat nga industria e nxjerrjes së mineraleve (MMPH) – 26.11.2018;

3.13. Projektligji për Ndërmarrjet Publike (MZHE) – 31.07.2018;

3.14. Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-183 për zbatimin e sanksioneve Ndërkombëtare (MPJ) – 21.12.2018;

3.15. Projektligji i Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (MASHT) – 31.07.2018;


3.16. Projektligji për tekstet dhe mjetet shkollore, lektyrë shkollore dhe dokumentacionin pedagogjik në Republikën e Kosovës (MASHT) – 30.11.2018;

3.17. Projektligji për Edukimin Parashkollor – Edukimin në Fëmijërinë e Hershme 0-6 vjeç në Republikën e Kosovës (MASHT) – 30.11.2018;

3.18. Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit MASHT – ERASMUS PLUS (MASHT) – 30.08.2018.

4. Obligohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/51

Datë: 12.06.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për Mbrojtjen e Fëmijës.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**



Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/51  
Datë: 12.06.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë nr. 02/59 i datës 17 nëntor 2015, kështu që: "Paga e Drejtorit të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës, Zëvendësdrejtorit dhe Kryeinspektorit, pas përfundimit të mandatit do të jetë në vlerë të 70% të pagës së plotë që kanë marrë gjatë muajit të fundit të mandatit të tyre. Kjo e drejtë u njihet për 5 vite pas përfundimit të mandatit.
2. Ky vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Qeverisë nr. 02/59 të datës 17.11.2015.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/51

Datë: 12.06.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese Nr. Ref : 64KK/18 të datës 11 qershor 2018, rasti Nr. KO 12/18 shfuqizohet vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 01/27 i datës 1 shkurt 2018 për pezullimin e përkohshëm të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 04/20 të datës 20 dhjetor 2017.
2. Obligohet Ministria e Administratës Publike që vendimin nr. 04/20 të datës 20 dhjetor 2017 ta akomodojë brenda Projektligjit për Pagat.
3. Obligohet Ministria e Financave, Ministria e Administratës Publike dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/51  
Datë: 12.06.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 paragrafi 4 të Ligjit nr. 04/L-036 mbi Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Plani Vjetor i Statistikave Zyrtare për vitin 2019.
2. Agjencia e Statistikave të Kosovës është e obliguar që pjesën e implikimeve financiare të këtij Plani ta harmonizojë me Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019.
3. Obligohet Agjencia e Statistikave e Kosovës për zbatimin e Planit nga pika 1. e këtij vendimi në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 06/51  
Datë: 12.06.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndahen mjete financiare në shumë prej 20,000,00 (njëzetmijë) euro për znj. Flutura Ibrahim.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi, ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara, me kod 13100, kategoria e Shpenzimeve të Rezervës dhe transferohen në Ministrinë e Financave, nën programi i Thesarit me kod 11200, kategoria e shpenzimeve subvencione dhe transfere. Këto mjete transferohen në xhirollogarinë Nr. 1901983065021191 Banka Kombëtare Tregtare.
3. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/51


Datë: 12.06.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për Kompetencat e zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**



Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/51


Datë: 12.06.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**



Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 09/51  
Datë: 12.06.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 10/51

Datë: 12.06.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Komunës së Prizrenit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të "ish-Sekretariatit Federativ për Mbrojtje Popullore", Zona Kadastrale Lubizhdë, me numra të parcelave: 248-1, 248-2, 249-0, 250-0, 251-0, 252-0, 253-0, 254-0, 255-0, 260-0, 261-0, 262-0, 263-0, 264-0, 266-0, 267-0, 268-0, 269-0, 1407-0, 1418-0, 1451-1, dhe t'i barten në shfrytëzim Komunës së Prizrenit.
2. Prona nga pika 1. e vendimit, i jepet në shfrytëzim me qëllim të realizimit të Planit Rregullues Urban, për shpalljen e zonës së veçantë Industri të Lehtë "Parku i Biznesit", i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Prizrenit më datë 29.02.2012.
3. Prona e dhënë në shfrytëzim, nuk mund të shfrytëzohet për qëllime të tjera, përveç asaj të paraparë në Planin Rregullues Urban.
4. Obligohet Agjencia Kadastrale e Kosovës që të bëjë regjistrimin e pronës sipas pikës 1. të këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*


---

Nr. 11/51  
Datë: 12.06.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, për të kërkuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministrit të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, për nënshkrimin e Marrëveshjes së bashkëfinancimit me Agjencionin Gjerman për Bashkëpunim Ndërkombëtar GIZ për Projektin CETEP.
2. I rekomandohet Presidentit të Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit për nënshkrimin e marrëveshjes nga pika 1. e këtij vendimi, në pajtim me afatin e përcaktuar në Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 12/51  
Datë: 12.06.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohen Udhëzimet e politikave nga Konkluzionet e Përbashkëta të Dialogut Ekonomik dhe Financiar ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë. Udhëzimet e politikave të shqyrtuara në kuadër të Dialogut Ekonomik dhe Financiar me BE-në, përfshijnë:
  - 1.1. Rritja institucionale dhe të sigurojë staf adekuat në Ministrinë e Financave me qëllim të përmirësimit të planifikimit makro-fiskal, parashikimeve dhe vlerësimeve të ndikimit fiskal. Gjithashtu të përgatitet një dokument me opsione lidhur me themelimin e një organi të pavarur për mbikëqyrjen fiskale për konsultime të mëtejme me palët e interesit, përfshirë BE-në.
  - 1.2. Kompletimi i procesit të certifikimit të veteranëve të luftës si dhe ri-klasifikimit me synim të uljes së kostos së skemës pensionale të veteranëve të luftës në përputhje me legjislacionin aktual. Fuqizimi i kapaciteteve institucionale në nivel qendror dhe lokal të qeverisë për planifikimin e investimeve shumëvjeçare dhe përgatitjen dhe menaxhimin e projekteve të investimeve për të përmirësuar ekzekutimin e shpenzimeve kapitale.
  - 1.3. Banka Qendrore të vazhdojë zgjerimin e instrumenteve analitike duke zhvilluar pyetësor për pritshmërinë e inflacionit. Gjithashtu, të sigurohet që Banka Qendrore të mos shndërrohet në "de facto" financuesin e Qeverisë së Republikës së Kosovës duke blerë letra me vlerë të emetuara nga Qeveria. Më tutje, të adresojë faktorët ligjorë dhe institucionalë që pengojnë qasjen në financim të NMV-ve, përderisa me kujdes të monitorojë rritjen e kreditimit për ekonomitë familjare. Të finalizohet korniza e menaxhimit të krizave dhe ndërhyrjeve të jashtëzakonshme për banka, me qëllim të fuqizimit dhe stabilitetit të sektorit bankar.
  - 1.4. Të miratohet Ligji për Eficiencën e Energjisë dhe krijimi i Fondit për Eficiencë të Energjisë. Të miratohen stimuj të eficiencës së energjisë për sektorin privat dhe ekonomitë familjare. Të avancohet puna në de-rregullimin e çmimeve të furnizimit me energji elektrike dhe të përfundojë studimi me qëllim të miratimit të një plani për përshtatjen graduale të tarifave të energjisë për të pasqyruar kostot aktuale.

- 1.5. Të miratohet Strategjia e re dhe Plan i Veprimit 2019-2022 për të luftuar ekonominë joformale e cila duhet të përfshijë objektiva cilësore dhe sasiore.
- 1.6. Të monitorohet zbatimi i Planit të Veprimit për punësimin e të rinjve dhe të rritet fushëveprimi i masave aktive të tregut të punës, në veçanti për gratë. Të kryhet analiza e shkathtësive të nevojshme për identifikimin e sektorëve prioritarë për ta ndërlidhur me rishikimin e profileve profesionale dhe kurrikulave. Të plotësohen hapat e nevojshëm për aplikimin e skemës së përgjithshme të sigurimeve shëndetësore. Të rritet regjistrimi në arsimin parashkollor.
2. Obligohen ministratë përgjegjëse, dhe institucionet tjera të ndërmarrin masa për zbatimin e këtyre udhëzimeve të politikave.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ



Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 13/51  
Datë: 12.06.2018


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**Për hartimin e Programit për Reforma Ekonomike 2019-2021**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës përgatitë Programin për Reforma Ekonomike 2019-2021 (në vijim PRE), si pjesë e dialogut ndërmjet BE-së dhe Republikës së Kosovës në kuadër të qeverisjes ekonomike.
2. PRE mbulon periudhën afatmesme trevjeçare 2019-2021 dhe bazohet në kornizën makro-fiskale, prioritetet e reformave strukturore dhe masat përkatëse që janë pjesë e Programit të Qeverisë 2017-2021 dhe Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021.
3. Duke u bazuar në Udhëzimet e Komisionit Evropian, përmes Programit për Reforma Ekonomike raportohet për zbatimin e rekomandimeve nga Konkluzionet e përbashkëta të Dialogut Ekonomik dhe Financiar në mes BE-së dhe Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë të datës 25 maj 2018.
4. Ministri i Financave koordinon procesin e hartimit të PRE në cilësinë e Koordinatorit Nacional të Programit për Reforma Ekonomike.
5. Koordinatori Nacional i Programit për Reforma Ekonomike mbështetet nga:
  - 5.1. Zyra për Planifikim Strategjik e Zyrës së Kryeministrit (ZPS) për agjendën e reformave strukturore, që përfshijnë politikat publike sipas fushave të përcaktuara me udhëzimet e Komisionit Evropian;
  - 5.2. Departamenti për Politika Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar (Ministria e Financave) lidhur me kornizën makro-ekonomike dhe politikat fiskale, duke përfshirë masat mbështetëse fiskale;
  - 5.3. Ministritë e tjera të linjës në varësi të temave që trajtohen në PRE.
6. Sipas udhëzimeve të Koordinatorit Nacional, ZPS fton ministritë e linjës dhe institucionet tjera sipas fushave të përcaktuara me Udhëzuesin e Komisionit Evropian për të kontribuar në procesin e hartimit dhe takimet e punës së Programit për Reforma Ekonomike.

7. Sipas fushave të përcaktuara nga Komisioni Evropian, Koordinatorin Nacional, me propozim të ministrive/institucioneve përkatëse, emëron koordinatorët e fushave, të cilët janë përgjegjës të japin kontributin e tyre në hartimin e prioriteteve të reformave strukturore të PRE-së.
8. Koordinatorët e emëruar nga ministrinë përgjegjëse për fushat e mëposhtme, përbëjnë ekipin qendror të procesit të hartimit të PRE-së
  - 8.1. Reformat në tregu e Energjisë dhe Transportit;
  - 8.2. Zhvillimet sektoriale;
  - 8.3. Mjedisi biznesor dhe zvogëlimi i ekonomisë informale;
  - 8.4. Hulumtimi, zhvillimi dhe inovacioni (HZHI) dhe Ekonomia Digjitale;
  - 8.5. Reformat lidhur me Tregtinë;
  - 8.6. Arsimi dhe shkathtësitë;
  - 8.7. Punësimi dhe Tregu i punës;
  - 8.8. Gjithëpërfshirja dhe mbrojtja sociale.
9. Në procesin e hartimit të PRE përfshihen gjithashtu përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, sektorit privat dhe partnerëve të tjerë për të dhënë kontributin e tyre në përzgjedhjen e prioriteteve të reformave strukturore.
10. Duke u bazuar në këtë vendim, ZPS në koordinim me Koordinatorin Nacional për PRE do të përgatisë një kalendar të procesit të hartimit të PRE-së dhe do ta ndajë atë me ministrinë përkatëse.
11. Prioritizimi i masave të Programit për Reforma Ekonomike 2019-2021, pasi që masat të përgatiten nga koordinatorët sektorial dhe shqyrtohen nga Zyra për Planifikim Strategjik, do të bëhet nga Komisioni për Planifikim Strategjik.
12. Drafti final i Programit për Reforma Ekonomike 2019-2021 aprovohet nga Komisioni për Planifikim Strategjik para se të dërgohet për miratimin përfundimtar në Qeveri.
13. Koordinatorin Nacional e prezanton draftin e PRE-së për konsultim të jashtëm me partnerët social, komunitetin e bizneseve, asociacionet dhe sindikatat, shoqërinë civile, pushtetin lokal dhe komisionet përkatëse parlamentare.
14. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 14/51

Datë: 12.06.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2018, nxjerr këtë:


**V E N D I M**

1. Emërohen anëtarët e Këshillit Kosovar për Raportim Financiar, në këtë përbërje:

|                                                         |          |
|---------------------------------------------------------|----------|
| 1.1. Z. Afrim Maloku, Oda Ekonomike Amerikane,          | kryetar; |
| 1.2. Znj. Nexhmije Vokshi, Fakulteti Ekonomik,          | anëtare; |
| 1.3. Z. Nexhat Shala, Oda Ekonomike e Kosovës,          | anëtar;  |
| 1.4. Z. Visar Zeneli, BQK,                              | anëtar;  |
| 1.5. Znj. Fatime (Muji) Regjepi, Ministria e Financave, | anëtare; |
| 1.6. Znj. Lumnije Ajdini Aleanca kosovare e Biznesit,   | anëtare; |
| 1.7. Z. Arbër Hoti, SHKÇAK,                             | anëtar.  |

2. Anëtarët e Këshillit Kosovar për Raportim Financiar emërohen për një periudhë trevjeçare.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---


Nr. 15/51  
Datë: 12.06.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M   P Ë R F U N D I M T A R**

1. Aprovohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit "Ndërtimi i Rugës Rajonale R 129 Kërpimëh –Mitrovicë", Zonat Kadastrale Revuq dhe Pakashticë e Poshtme të Komunës së Podujevës, sipas tabelave pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave dhe tabelat e bashkangjitura këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit, sipas tabelave të vlerësimit në "Shkresë përcjellëse e Aktit të Vlerësimit" Nr. Protokolli 1653/18 datë 27.03.2018.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas aprovimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
5. Kundër këtij vendimi subjekti kërkues, cildo person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat pjesë përbërëse të këtij vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.

6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.
7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
8. Ky vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastralë në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra kadastrale është e obliguar të kryejë veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 16/51  
Datë: 12.06.2018


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R**

1. Aprovohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit "Ndërtimi i Rrugës Prishtinë-Pejë, Segmenti Balincë-Pejë, Zona Kadastrale Balincë, Komuna Malishevë", sipas tabelës pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave dhe tabelën pjesë përbërëse të këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit, sipas tabelës së vlerësimit në "Shkresë përcjellëse e Aktit të Vlerësimit" Nr. Protokolli 1715/18 datë 20.03.2018.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas aprovimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, ia dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
5. Kundër këtij vendimi subjekti kërkues, cildo person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat pjesë përbërëse të këtij vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike ka të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.



6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.
7. Brenda dy (2) vjetësh nga data e hyrjes në fuqi e vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
8. Ky vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastralë në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra kadastrale është e obliguar të kryejë veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 17/51  
Datë: 12.06.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të Rregullores nr. 06/2012 për Pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Z. Fitim Krasniqit, i vazhdohet mandati i Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit edhe për 3 (tre) vjet.
2. Z. Krasniqi i kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë